

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Dekreti - E urdhëroi Taulant Balla/ Bajram Begaj firmos me urgjencë ligjin e Ramës për pagat e magjistra tëve
ADRESA	https://www.syri.net/politike/917516/e-urdheroi-taulant-balla-bajram-begaj-firmos-me-urgjence-ligjin-e-rames-per-pagat-e-magjistrateve/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 08:54:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 08:47:17 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d7baba8238e360bc5402d99b6bedc5c766fa8c4f3425eae28f32a11d70480a80
TEKSTI	d34b3a1aa7ba9740073cb8be239574eca7b53094cc80badc2578ab42768bfcc2
PAMJA	bc2de9198a878eaca7b2b8c3f3803be37535eee56d9ba7842684a07e5d68ba7b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	739f25792c89b68d217b7c1511532d0325821701b5c12e6cf53211ab0bb3cbe7
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	35ab8d40f1b8a4415a5ce6150a0f35dfc65972e0cbe708d5f8ac326bd7570577
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/739f25792c89b68d217b7c1511532d0325821701b5c12e6cf53211ab0bb3cbe7>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**PROF. MYQEREM TAJ**

Shqipëria e harruar fillon aty ku shkolla mbetet pa nxënës!

**SONILA MEÇO**

'Në emër të popullit të Kosovës', prokura e një kurthi

**më të lexuarat**

'Akuza të stisura politikisht', Saiti: Dënimi i krerëve të UÇK, jo në emër të Kosovës

Specialja: Të akuzuarit vepruan së bashku për një qëllim të përbashkët kriminal, Taçi ishte anëtar kyc

Takimi sekret i DEA-s me vendet e Amerikës Latine/ Si po i damkos shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës

A e ndryshon vendimi i Hagës mënyrën si duhet parë UÇK-ja? Flet historiani Konrad Clewing! Faji individual, lufta e Kosovës dhe kufijtë...

By Pass i Elbasanit/ 'Karakçi në rrugën e Ballukut', Himci: S'dihet kur do përfundojë, tenderat po vidhen

'Taçi kishte dijeni për krimet, Veseli mori pjesë dhe inkurajoi kryerjen e tyre'



E urdhëroi Taulant Balla/ Bajram Begaj firmos me urgjencë ligjin e Ramës për pagat e magjistratëve

10:47, 18/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

Ashtu siç pritej, presidenti Bajram Begaj firmosi me urgjencë ligjin për pagat e magjistratëve.

Një ditë pas votimit në Kuvend të ligjit për pagat e magjistrave vetëm me votat e Partisë Socialiste, Begaj ka dekretuar këtë ligj.

Dje ligji për pagat e magjistrave u miratua me 84 vota, ndërsa opozita kërkoi që votimi të shtyhej, pasi nuk ishin reflektuar disa ndryshime.

Reagimi urgjent i Begajt vjen pasi kryetari i grupit parlamentar, Taulant Balla, e 'kishte urdhëruar' diçka të tillë dje në Kuvend.

"I bëj edhe thirrje Presidentit të Republikës, besoj të kemi dakordësinë për të hyrë në fuqi menjëherë dhe të zhblokohen edhe pagat meqë është shqetësim," tha Balla.

Ndërkohë, edhe Begaj jep këtë justifikim në mesazhin e tij për dekretimin e ligjit.

NJOFTIMI I PRESIDENCES

Presidenti i Republikës nxori sot dekretin për shpalljen e ligjit nr. 95/2026, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar", pasi kishte dhënë më parë pëlqimin për hyrjen në fuqi të tij menjëherë.

Presidenti i Republikës dha pëlqimin për hyrjen në fuqi të ligjit menjëherë bazuar në kërkesën e Kuvendit, i cili argumentonte nevojën dhe urgjencën për hyrjen në fuqi menjëherë me faktin se shfuqizimi i dispozitave për pagat e magjistratëve nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese kishte bllokuar dhënien e pagave për të gjithë gjyqtarët dhe prokurorët, që nga data 1 gusht 2026 e në vazhdim.

Pa hyrjen në fuqi të ligjit të ri, Thesari i Shtetit nuk mund të çlirojë pagesat për magjistratët.

Qëllimi i Kuvendit ishte që të mundësonte pagesat e Thesarit të Shtetit për gjyqtarët dhe prokurorët që në datën 18 shtator 2026 për pagat e bllokua nga data 1 gusht 2026 dhe për ato vijuese. Hyrja në fuqi e ligjit sipas procedurave të zakonshme do ta vononte këtë proces nga 15 deri në 35 ditë. Dhënia e pëlqimit nga Presidenti i Republikës për hyrjen e ligjit në fuqi menjëherë është prerogativë dhe instrument kushtetues, i cili justifikohet nga nevoja dhe urgjenca e rrethanave të rastit.

Argumentet dhe kundër-argumentet kushtetuese lidhur me masën e pagës mund të debatohen edhe në instanca të tjera kompetente, por zhblokimi në rrugë të ligjshme i vetë pagës mund të bëhet vetëm duke futur në fuqi ligjin e ri.

Hyrja e ligjit në fuqi menjëherë kërkon që Presidenti i Republikës të veprojë menjëherë.

Për Presidentin e Republikës, dhënia e pëlqimit në këtë rast i shërben mbrojtjes së një nevoje akute, me lidhje të drejtpërdrejtë me parimin e pavarësisë së gjyqësorit, që është garantimi i standardit të jetesës dhe i qëndrueshmërisë së të ardhurave për të gjithë magjistratët e vendit.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Bardhi - Ramës: Po hakmerresh ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve se të trokitën në derë për aferat ku je zhytur



By Pass i Elbasanit/ 'Karakaçi në rrugën e Ballukut', Himci: S'dihet kur do përfundojë, tenderat po vidhen



Takimi sekret i DEA-s me vendet e Amerikës Latine/ Si po i damkos shqiptarët narko-shteti i Edi Ramës

Ligji për statusin e magjistratëve të hiqet nga rendi i ditës, Bardhi denoncon skandalin: Në Kuvend versioni i ri i pakonsultuar me asnjë...

'Vendimi i Hagës, i pabazuar dhe pa fakte', Veseli: Akuzat, të stisura e fabrikua në Serbi

PD: Shpopullimi i Shqipërisë, një krizë që po zbraz vendin dhe po rrezikon të ardhmen e tij

TË NGJASHME



'Performanca' e Klodiana Spahiut në Kuvend/ Alimehmeti: Humbje qetësie! A është modeli 'Kayo' mision?!



Edhe sot protestë kundër vendimit të Speciales ndaj ish-krerëve të UÇK-së



'Djali i Pankartës', Ani Marku tregon detaje nga shoqërimi: Pankarta simbol kombëtar, ofenduese si e hodhën



'Policia u sul ndaj protestuesve si bishë e egërsuar', Tepelena: U jemi kthyer në makth!



Pagat e magjistratëve/ Rama miraton sa 0.02% e pagës së Presidentit, 'injonon' sistemin gjyqësor! PD: Puç kushtetues



Mbyllet marshimi i protestës së 110-të/ Protestuesit vijnë të qëndrojnë te Komisarati nr. 1



Vendimi i Hagës, Berisha: Ua them shqiptarëve, rolin më negativ, e ka luajtur Edi Rama...

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net